

Neni ...
Prokurori i Përgjithshëm

- i Prokurori i Përgjithshëm ka përgjegjësi për punën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë për periudhën zgjedhore.
- i Prokurori i Përgjithshëm, brenda dy javëve nga caktimi i datës së zgjedhjeve, nxjerr udhëzim të përgjithshëm me shkrim për prokurorët e prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm dhe për oficerët e policisë gjyqësore, si dhe mbikëqyr zbatimin e tij. Ai udhëzon në vecanti:
 - i Ngritjen dhe organizimin e grupeve hetimore për hetimin me përparësi të krimeve zgjedhore;
 - i Kriteret për shpërndarjen e çështjeve penale për krimet zgjedhore prokurorëve;
 - i Kryerjen me përparësi të verifikimeve sipas ligjit të dekriminalizimit;
 - i Bashkëpunimin midis prokurorive për shkëmbimin e shpejtë të informacionit dhe të mbledhjes së provave;
 - i Raportimin periodik dhe të koordinuar pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e udhëzimit të tij, për gjendjen e kriminalitetit sipas rretheve gjyqësore, për bashkëpunimin me policinë e shtetit, si dhe për problematikat e evidentuara.
- i Prokurori i Përgjithshëm, kur konstaton shkelje disiplinore të prokurorëve ose të policisë gjyqësore përgjatë kryerjes së hetimeve të veprave penale zgjedhore në kompetencë të kësaj prokurorie, paraqet brenda 5 ditëve ankesë me shkrim tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose tek Komisioni Disiplinor për Policinë Gjyqësore.
- i Brenda 3 muajve nga përfundimi i periudhës zgjedhore, Prokurori i Përgjithshëm raporton përpara Kuvendit mbi gjendjen e kriminalitetit gjatë periudhës zgjedhore.

Neni ...
Drejtuesi i prokurorisë

- i Drejtuesi i prokurorisë organizon punën dhe merr masat e nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë në periudhën zgjedhore, si dhe garanton zbatimin korrekt të udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm që lidhet me periudhën zgjedhore.
- i Ai krijon grupet hetimore për krimet zgjedhore, mbikëqyr planifikimin e punës së tyre, kërkon informacion mbi ecurinë e procedimeve të regjistruara, nxjerr udhëzime me shkrim për to nëse është e nevojshme, jep urdhra për Policinë Gjyqësore, udhëzon me shkrim kryerjen e veprimeve procedurale, verifikon ecurinë dhe përfundimin e çështjeve, si dhe bashkërendon punën me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Policinë Gjyqësore.
- i Drejtuesi i Prokurorisë, brenda 1 jave nga nxjerrja e udhëzimit të prokurorit të përgjithshëm vlerëson dhe nëse është e nevojshme, rishikon rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë për të siguruar mbarëvajtjen e punës gjatë periudhës zgjedhore.
- i Drejtuesi i Prokurorisë, kur konstaton shkelje disiplinore të prokurorëve ose të policisë

gjqësore përgjatë kryerjes së hetimeve të veprave penale zgjedhore në kompetencë të kësaj prokurorie, paraqet brenda 5 ditëve ankesë me shkrim tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose tek Komisioni Disiplinor për Policinë Gjyqësore.

Neni ...
Policia Gjyqësore

- i Policia gjyqësore ushtron me përparësi funksionet e saj në rastin e veprave penale zgjedhore. Ajo zbaton me korrektësi udhëzimin e Përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe cdo urdhër dhe udhëzim të prokurorit për këtë qëllim.
- i Nëse oficeri i policisë gjyqësore është caktuar në përbërje të një grupi hetimor që ka filluar hetimin për vepra penale zgjedhore, komandimi ose transferimi i tij është i ndaluar gjer në përfundimin e hetimeve paraprahe.

Neni ...
Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme

- i Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, brenda dy javëve nga caktimi i datës së zgjedhjeve:
 - i nxjerr udhëzim për procedurat administrative të vecanta gjatë periudhës zgjedhore;
 - i rivlerëson dhe nëse është e nevojshme rishikon rregulloren e funksionimit të Prokurorisë së Posacme;
 - i miraton rregulloret e nxjerra nga Drejtori i BKH-së që lidhen me hetimin e veprave penale në kompetencë të Prokurorisë së Posacme.
- i Pas konsultimit me Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe mbledhjes së prokurorëve të posacëm, Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, brenda dy javëve nga caktimi i datës së zgjedhjeve nxjerr udhëzim të përgjithshëm me shkrim për Byronë Kombëtare të Hetimit për përmirësimin e marrëdhënieve të punës, efikasitetin dhe garancitë midis dy institucioneve gjatë hetimit të veprave penale zgjedhore në kompetencë të Prokurorisë së Posacme.
- i Për veprat penale zgjedhore në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posacme, Drejtuesi i saj koordinon me përparësi punën e njësive që janë në kompetencën e tij me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, shërbimet e inteligjencës dhe autoritetet e tjera kompetente.
- i Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, kur konstaton shkelje disiplinore të prokurorëve ose të policisë gjyqësore përgjatë kryerjes së hetimeve të veprave penale zgjedhore në kompetencë të kësaj prokurorie, paraqet brenda 5 ditëve ankesë me shkrim tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë ose tek Komisioni Disiplinor për Policinë Gjyqësore.
- i Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, brenda dy muajve nga përfundimi i periudhës zgjedhore, raporton me shkrim pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë mbi

veprimtarinë e Prokurorisë së Posacme për veprat penale zgjedhore në kompetencë të saj.

Neni ...

Drejtuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit

- i Drejtuesi i BKH-së, brenda dy javëve nga caktimi i datës së zgjedhjeve, nxjerr rregulloren mbi metodologjinë e informimit të BKH-së nga punonjësit e policisë së shtetit për veprat penale në kompetencë të Prokurorisë së Posacme.
- i Drejtuesi i BKH-së, kur konstaton shkelje disiplinore të policisë gjyqësore përgjatë kryerjes së hetimeve të veprave penale zgjedhore, paraqet brenda 5 ditëve ankesë me shkrim tek **Komisioni Disiplinor [për t'u verifikuar]** për Policinë Gjyqësore.

Neni ...

Këshilli i Lartë i Prokurorisë

- i Këshilli i Lartë i Prokurorisë, brenda tre muajve nga përfundimi i periudhës zgjedhore raporton para Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjatë periudhës zgjedhore dhe rezultatet e raportuara nga Prokuroria e Posacme, si dhe kur është rasti rekomandon ndryshime ligjore për përmirësimin e organizimit dhe të funksionimit të prokurorisë.
- i Këshilli i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me raportin.

Neni ...

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

- i Inspektori i Lartë i Drejtësisë heton me përparësi cdo ankesë ndaj subjekteve në kompetencë të tij, që lidhet me veprat penale zgjedhore.
- i Brenda tre muajve nga përfundimi i periudhës zgjedhore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë raporton para Kuvendit mbi veprimtarinë e tij gjatë periudhës zgjedhore, si dhe i përgjigjet kërkesës së Kuvendit për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me raportin.